



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2025

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës suaj administruar pranë Bashkisë Shkodër datë 26.11.2025 me nr. 24331 prot. ku kërkohet informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit për Paketën e Maleve, ju informojmë si më poshtë:

1. Zonat prioritare të zhvillimit të shpallura sipas ligjit “Për Paketën e Maleve”, për bashkinë Shkodër janë të përcaktuara sipas V.K.M nr. 714, datë 26.11.2025 “Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Shkodër”.
2. Harta e këtyre zonave është e publikuar në V.K.M e sipërcituar.
3. Bashkëngjitur lista e kërkesave:
 - Numri i kërkesave të mbërritura nga qytetarët individë shtetas shqiptar apo të huaj, për të shprehur interes për identifikimin e zonave zhvillimore për Paketën e Maleve në Bashkinë Shkodër është në total 649 aplikime.
 - Numri i kërkesave të mbërritura nga bizneset për të shprehur interes për identifikimin e zonave zhvillimore për Paketën e Maleve në Bashkinë Shkodër është 0 aplikime.
 - Numri i aplikimeve të mbërritura nga individë shtetas shqiptarë është 642 aplikime.
 - Numri i aplikimeve të mbërritura nga individë shtetas të huaj është 7 aplikime.
 - Numri i kërkesave të mbërritura sipas llojit të zhvillimit (Agroturizëm, projekte sociale, blegtori, energjia e gjelbër, tjetër) konsiston në 434 aplikime për agroturizëm, 35 aplikime për projekte sociale, 29 aplikime për blegtori, 14 aplikime për energjinë e gjelbër dhe 137 aplikime në kategori të tjera.

Për çdo informacion shtesë apo sqarim, ju lutemi të na kontaktoni në mënyrë që të ofrojmë mbështetjen e nevojshme. Ju falenderojmë për mirëkuptimin!

K R Y E T A R

Benet BECI